

LIGJ
Nr. 66/2015

**PËR FALJEN E GJOBAVE PËR MOSPAGIMIN NË AFAT TË KONTRIBUTEVE TË
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NGA
SUBJEKTET JURIDIKE DHE FIZIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Falen, në masën 100 për qind, gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë evidentuar deri më 31 dhjetor 2014, në zbatim të neneve 113, “Mosdeklarimi në afat”, pavarësisht vlerës së detyrimit, dhe 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për subjektet juridike dhe fizike, kur kontributi dhe kamatëvonesa është paguar plotësisht deri në datën 30 shtator 2015.

Neni 2

Gjobat për mosdeklarimin dhe mospagimin në afatet ligjore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 3

Brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore fshin dënimet administrative, të falura sipas këtij ligji, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e saj.

Listat e subjekteve përfituese dhe vlera e gjobave përkatëse publikohen, brenda 3 muajve, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 4

Gjobat që janë në proces apelimi administrativ apo në proces gjyqësor falen, sipas përcaktimeve të nenit 1, të këtij ligji, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 5

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9171, datë 14.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani